



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK**

Nr. 1993/6 prot

Datë 19.09.2023

**V E N D I M**

**Nr. 924/2023**

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

Jonaid Myzyri	Kryetar
Kreshnik Ternova	Anëtar
Anila Malaj	Anëtar

Në mbledhjen e datës 19.09.2023, shqyrtoi çështjen me:

- Objekt:** Shfuqizimi i vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave mbi skualifikimin e ofertës të paraqitur nga bashkimi i operatorëve ekonomikë “GB Civil Engineering” SHPK & “Margarita Kodra” PF në procedurën e prokurimit “*Shërbim Konsulence*”, me Nr. REF-75634-07-20-2023, me objekt: “*Supervizion punimesh, riveshje dhe sistemim asfaltim nyja Shkozet mbikalimi Plepa*”, me fond limit 1,346,516.84 lekë (pa TVSh), zhvilluar me datë 01.08.2023, nga autoriteti kontraktor, Autoriteti Rrugor Shqiptar.
- Ankimues:** Bashkimi i operatorëve ekonomike “GB Civil Engineering” SHPK & “Margarita Kodra” PF  
Rruga e Kavajës, ish-Parku, pranë "Tregut 100 Vitrinat", Kulla C, Shkalle 2, Tiranë
- Autoriteti Kontraktor:** Autoriteti Rrugor Shqiptar  
“Rruga: Sami Frashëri, nr. 33”, Tiranë
- Baza Ligjore:** Ligji nr. 162/2020 “*Për Prokurimin Publik*”, Vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766/2021, datë 13.10.2021 “*Për miratimin e rregullave “Për Organizimin dhe Funksionimin e Komisionit të*

*Prokurimit Publik” , Neni 4 i Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19”.*

Komisioni i Prokurimit Publik, pasi dëgjoi relatorin e çështjes, shqyrtoi parashtrimet me shkrim të ankimuesit, dokumentacionin e paraqitur nga autoriteti, pretendimet e ankimuesit, dhe pasi diskutoi çështjen në tërësi,

## **Vëren:**

### **I**

#### *Vlerësimi Paraprak*

I 1. Vlera limit e përlogaritur për procedurën e prokurimit objekt-ankimi është nën kufirin e ulët monetar, ndaj shqyrtimi dhe vendimmarrja do të bëhet nga 3 anëtarë, në përputhje me pikën 1, të nenit 30 të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik” dhe Rregullat e Prokurimit Publik.

I.2. Ankimuesi ka *prima facie* interes në këtë procedurë prokurimi dhe për këtë arsye legjitimohet për të paraqitur ankesë në lidhje me të.

I.3. Ankimuesi ka paraqitur ankesë pranë autoritetit kontraktor dhe njëherazi pranë Komisionit të Prokurimit Publik, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në ligjin nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”.

I.4. Ankimuesi ka respektuar afatet ligjore të paraqitjes së ankesës pranë autoritetit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik.

### **II**

#### *Rrethanat e çështjes*

II.1. Në datën 21.07.2023, është publikuar në SPE procedura e prokurimit “*Shërbim Konsulencë*”, me Nr. REF-75634-07-20-2023, me objekt: “*Supervizion punimesh, riveshje dhe sistemim asfaltim nyja Shkozet mbikalimi Plepa*”, me fond limit 1,346,516.84 lekë (pa TVSh), zhvilluar me datë 01.08.2023 nga autoriteti kontraktor, Autoriteti Rrugor Shqiptar.

II.2. Në datën 01.08.2023, referuar sistemit elektronik të prokurimit (SPE) rezulton, se autoriteti kontraktor ka zhvilluar fazën e parë të procedurës së mësipërme të prokurimit (shprehja e interesit).

- BOE “ERSI/M & A.SH.Engineering”

I Skualifikuar

-BOE “GB Civil Engineering & Margarita Kodra”

I Skualifikuar

-BOE “HTS Company & HE & SK 11”	I kualifikuar
-“INFRATECH”	I Skualifikuar
-NOVATECH STUDIO”	I Skualifikuar
“S& STUDIO”	I Skualifikuar
-STUDIO SERVICES D&S”	I Skualifikuar
-“TOËER”	I kualifikuar

II.3. Në datën 07.08.2023, autoriteti kontraktor ka njoftuar operatorët ekonomik pjesëmarrës mbi vendimin e Komisionit të Vlerësimit të Ofertave për përzgjedhjen e kandidatëve pas fazës së parakualifikimit ku rezulton, se BOE “GB Civil Engineering & Margarita Kodra”, është i skualifikuar.

II.4. Në datën 14.08.2023 pranë Komisionit të Prokurimit Publik dhe autoritetit kontraktor, është depozituar ankesa me nr. 1993 prot., e bashkimit të operatorëve ekonomikë “GB Civil Engineering & Margarita Kodra”, për procedurën e prokurimit “*Shërbim Konsulencë*”, me Nr. REF-75634-07-20-2023, me objekt: “*Supervizion punimesh Riveshje dhe sistemim asfaltim nyja Shkozet mbikalimi Plepa*”, me fond limit 1,346,516.84 lekë (pa TVSh), zhvilluar me datë 01.08.2023 nga autoriteti kontraktor, Autoriteti Rrugor Shqiptar.

Nga shqyrtimi paraprak i ankesës, u konstatua, se objekti i saj lidhet me kundërshtimin e vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave, mbi skualifikimin e ofertës së bashkimit të operatorëve ekonomikë “GB Civil Engineering & Margarita Kodra” nga procedura e prokurimit të sipërcituar me pretendimet si më poshtë vijon:

*“[.....Ne si BOE “GB Civil Engineering” SHPK & “Margarita Kodra” PF, pasi jemi njohur me DST e publikuar në SPE nga ana e autoritetit kontraktor, kemi përgatitur dhe depozituar dokumentacionin e kërkuar sipas shtojcës 11, duke përmbushur kërkesat e paraqitura në DST. Arsyeja e skualifikimit është se: “Bazuar në Dokumentet Standarde të Tenderit, dhe në Deklaratën e Operatorit “stafi teknik i shoqërisë dhe stafi profesional i deklaruar i Operatorit nuk duhet të jenë të angazhuara në kontrata të tjera apo të deklaruar në procedura të shpallura fitues”. Inxhinierët e angazhuar (në këtë rast është vetëm inxhinieri i mjedisit i angazhuar), në kontratën me Autoriteti Rrugor Shqiptar me objektin “Supervizion punimesh përfundimi i punimeve në segmentet rrugore Ura e Kranesë-Qafë Botë, Ura e Kranesë-ura e Gajdarit dhe përmirësimi i segmentit rrugor Shijan-Ura e Gajdarit”, në momentin që është deklaruar pezullimi pa afat deri në zgjidhjen e problematikave nga ana e autoritetit kontraktor Autoriteti Kontraktor (ARRSH) janë të lirë të angazhohen në projekte të tjera në kuadër të angazhimeve të ndryshme teknike të subjektit “GB Civil Engineering” SHPK. Në këtë moment e shikojmë të padrejtë, për të disatën herë, skualifikimin e anëtarëve të stafit “GB Civil Engineering” SHPK në procedura të tjera të konkurrimit. Përfundimisht, kërkojmë nga ana juaj rishikimin e këtij arsyetimi diskriminues për të na skualifikuar nga procedurat e prokurimit të zhvilluara nga Autoriteti Rrugor Shqiptar..]”.*

II.5. Bazuar në nenin 112, pika 3, të ligjit 162/2020 “Për prokurimin Publik”, Komisioni i Prokurimit Publik ka publikuar në bazën e të dhënave të tij, të dhëna për: a) ankimuesin, adresën dhe NUIS-in; b) të dhëna të plota për procedurën e prokurimit (objekt, numër

reference, fond limit, datën e zhvillimit të procedurës) si dhe formularin e publikimit me nr. 1993/2 prot., datë 15.08.2023, lidhur me arsyet e skualifikimit të bashkimit të operatorëve ekonomikë ankimues “GB Civil Engineering & Margarita Kodra”.

II.6. Nëpërmjet shkresës nr. 6709/3 prot., datë 21.08.2023, protokolluar me tonën respektivisht me nr. 1993/3 prot., datë 23.08.2023, është depozituar pranë Komisionit të Prokurimit Publik informacioni dhe dokumentacioni përkatës i autoritetit kontraktor lidhur me trajtimin e ankesës për procedurën e mësipërme të prokurimit, duke vendosur mospranim të ankesës.

II.7. Me shkresën nr. 1993/4 prot., datë 24.08.2023, Komisioni i Prokurimit Publik i është drejtuar autoritetit kontraktor “Autoriteti Rrugor Shqiptar”, duke i kërkuar informacion të hollësishëm mbi procedurën e mësipërme të prokurimit, ku të pasqyrohet procesi i hartimit dhe miratimit të dokumenteve standarde të tenderit, procesi i shqyrtimit dhe vlerësimit të ofertave, dokumentacioni i bashkimit të operatorëve ekonomikë ankimues “GB Civil Engineering” SHPK & “Margarita Kodra” PF”, si dhe të jepen argumentimet përkatëse mbi pretendimet e bashkimit të operatorëve ekonomikë “GB Civil Engineering” SHPK & “Margarita Kodra” PF.

II.8. Nëpërmjet shkresës nr. 6878/1 prot., datë 29.08.2023, protokolluar me tonën respektivisht me nr. 1993/5 prot., datë 30.08.2023, është depozituar pranë Komisionit të Prokurimit Publik informacioni dhe dokumentacioni përkatës nga autoriteti kontraktor.

II.9. Referuar nenit 113, të ligjit 162/2020 “Për prokurimin publik”, nuk është paraqitur asnjë argumentet nga operatorë ekonomikë të interesuar pranë Komisionit të Prokurimit Publik, në lidhje me procedurën e prokurimit objekt - ankimi.

### III

#### **Komisioni i Prokurimit Publik**

Komisioni i Prokurimit Publik, pas shqyrtimit të ankesës, dokumentacionit bashkëngjitur saj si dhe informacionit të autoritetit kontraktor,

#### **Arsyeton:**

III.1. Lidhur me pretendimin e BOE “GB Civil Engineering” SHPK & “Margarita Kodra” PF, mbi kundërshtimin e skualifikimit të ofertës së paraqitur prej tij, në procedurën e prokurimit objekt-shqyrtimi me arsyen : *“[.....Ne si BOE “GB Civil Engineering” SHPK & “Margarita Kodra” PF, pasi jemi njohur me DST e publikuar në SPE nga ana e autoriteti kontraktor, kemi përgatitur dhe depozituar dokumentacionin e kërkuar sipas shtojcës 11, duke përmbushur kërkesat e paraqitura në DST. Arsyeja e skualifikimit është se: “Bazuar në Dokumentet Standarde të Tenderit, dhe në Deklaratën e Operatorit “stafi teknik i shoqërisë dhe stafi profesional i deklaruar i Operatorit nuk duhet të jenë të angazhuara në kontrata të*

tjera apo të deklaruar në procedura të shpallura fitues”. Inxhinierët e angazhuar (në këtë rast është vetëm inxhinieri i mjedisit i angazhuar), në kontratën me Autoriteti Rrugor Shqiptar me objektin “Supervizion punimesh përfundimi i punimeve në segmentet rrugore Ura e Kranesë-Qafë Botë, Ura e Kranesë-ura e Gajdarit dhe përmirësimi i segmentit rrugor Shijan-Ura e Gajdarit”, në momentin që është deklaruar pezullimi pa afat deri në zgjidhjen e problematikave nga ana e autoritetit kontraktor Autoriteti Kontraktor (ARRSH) janë të lirë të angazhohen në projekte të tjera në kuadër të angazhimeve të ndryshme teknike të subjektit “GB Civil Engineering” SHPK. Në këtë moment e shikojmë të padrejtë, për të disatën herë, skualifikimin e anëtarëve të stafit “GB Civil Engineering” SHPK në procedura të tjera të konkurrimit. Përfundimisht, kërkojmë nga ana juaj rishikimin e këtij arsyetimi diskriminues për të na skualifikuar nga procedurat e prokurimit të zhvilluara nga Autoriteti Rrugor Shqiptar..]”, Komisioni i Prokurimit Publik vëren se:

III.1.1. Në pikën 2.3.3. të dokumenteve standarde të tenderit kemi kriterin sipas të cilit:

“2.3.3. Operatori ekonomik pjesëmarrës, për realizimin e shërbimeve objekt - kontrate, duhet të disponojë personelin kryesor, si më poshtë:

1. Drejtuesin e projektit, që duhet të jetë inxhinier ndërtimi me licencë dhe me eksperiencë pune në mbikëqyrje, i cili mban përgjegjësi për zbatimin e projektit sipas kushteve teknike të zbatimit, miratimin e volumeve të punimeve, certifikatën e pagesës, mbajtjen, kontrollin dhe miratimin e gjithë dokumentacionit, miratimin e ndryshimeve të volumeve, korrespondencën me ARRSH.

2. Mbikëqyrësin për punimet e sinjalistikës, i cili duhet të jetë inxhinier mekanik me licencë dhe me eksperiencë pune në këtë fushë. Ai miraton materialet dhe cilësinë e tyre dhe ndjek e miraton cilësinë e punimeve të sinjalistikës horizontale e vertikale (të përkohshme dhe të përhershme), si dhe sigurinë rrugore, gjatë kryerjes së punimeve dhe pas tyre.

3. Mbikëqyrësin për punimet topografike, që duhet të jetë inxhinier topograf / gjeodet me licencë dhe me eksperiencë pune në këtë fushë, i cili kontrollon dhe miraton volumet, piketimet dhe kuotëzimin e objektit.

4. Mbikëqyrësin për punimet e mjedisit, që duhet të jetë inxhinier mjedisi me licencë dhe me eksperiencë pune në këtë fushë..

Kriteri konsiderohet i përmbushur me paraqitjen e formularit të vetëdeklarimit sipas shtojcës 12 “Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar, i pari dorëzimin e dokumenteve provuese”, si më poshtë:

Për secilin pjesëtar të stafit kryesor të mësipërm duhet të paraqesë: Kontratë pune e vlefshme, Diplomë, Librezë pune, CV, si dhe licencat profesionale për mbikëqyrje për objektin që prokurohet.

Shënim: Për efekt të vlerësimit me pikë operatorët mund të ngarkojnë në fazën e parë ose të dytë dokumentacionin e kërkuar lidhur me pikën 2.3.3.

\*Në rastin e procedurës së prokurimit “Shërbim konsulence”, stafi i angazhuar të paraqesë deklaratë disponueshmërie për kryerjen e shërbimeve që ka marrë përsipër të realizojë”.

III.1.2. Në shtojcën 7 “**DEKLARATË Mbi disponueshmërinë e anëtarit të stafit të konsulentit**”, në dokumentet standarde të tenderit të procedurës së prokurimit objekt-ankimi, autoriteti kontraktor ka kërkuar si më poshtë vijon:

#### **Shtojca 7**

[ Shtojcë për t’u plotësuar nga Operatori Ekonomik]

#### **DEKLARATË**

#### **Mbi disponueshmërinë e anëtarit të stafit të konsulentit**

Deklaratë për procedurën e prokurimit publik që do të zhvillohet në datë \_\_\_\_\_ nga Autoriteti/Enti Kontraktor \_\_\_\_\_ me objekt \_\_\_\_\_ me fond limit \_\_\_\_\_.

Në bazë të parashikimeve të neneve 41 dhe 54 të VKM Nr. 285, datë 19.5.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, Unë i nënshkruari \_\_\_\_\_, në cilësinë e anëtarit të stafit të Konsulentit “.....” për procedurën e prokurimit me objekt \_\_\_\_\_ nën përgjegjësinë time personale, **Deklaroj** se:

1. Autorizoj VETËM Konsulentin “.....” të paraqesë personin tim dhe të gjithë dokumentacion e nevojshëm, si anëtar i stafit të tij në procedurën e prokurimit publik që do të zhvillohet në datë \_\_\_\_\_ nga Autoriteti/Enti Kontraktor \_\_\_\_\_ me objekt \_\_\_\_\_ me fond limit \_\_\_\_\_.

Deklarimi i personit tim, si anëtar i stafit nga ana e çdo konsulenti tjetër, për procedurën e prokurimit me objekt \_\_\_\_\_, është i pamiratuar dhe pa pëlqimin e personit tim.

#### **2. Jam i disponueshëm në realizimin e objektit të prokurimit, sipas kushteve dhe afateve të përcaktuara nga autoriteti/enti kontraktor.**

3. Nuk ndodhem në kushtet e konfliktit të interesit, **me asnjë** nga anëtarët e stafit të autoritetit/entit kontraktor, drejtpërdrejtë ose jo, i përfshirë në ndonjë pjesë të përgatitjes së kushteve të kontratës dhe/ose në procesin e përzgjedhjes për këtë kontratë dhe/ose për mbikëqyrjen e kësaj kontrate.

Data e dorëzimit të deklaratës \_\_\_\_\_

**Emri, Mbiemri, Nënshkrimi**

Vula

III.1.3. Në shtojcën 12 “Formulari Përmbledhës i Vetëdeklarimit” në dokumentet standarde të tenderit të procedurës së prokurimit objekt-ankimi,

#### **B: DEKLARATË**

**Për disponimin e punonjësve dhe makinerive të nevojshme (nëse kërkohen)**

<b>Deklarata</b>	<b>Përgjigje</b>
<p>Në cilësinë e operatorit ekonomik, deklaroj nën përgjegjësinë time të plotë se:</p> <p><u>Unë kam punonjësit e nevojshëm si dhe mjetet dhe makineritë për ekzekutimin e kontratës, siç përcaktohet në dokumentet e tenderit, dhe e vërtetoj këtë me dokumentacionin përkatës, të cilin do ta paraqes në kopje origjinale ose të noterizuar nëse fitoj, ose nëse më kërkohen sqarime nga autoriteti/enti kontraktor.</u></p>	<p><u>Punonjës</u></p> <p>Po [ ] Jo [ ]</p> <p>Nëse, po, numri i punonjësve:</p> <hr/> <p><u>Profili i punonjësve</u></p> <hr/> <p><u>Makineri e mjete</u></p> <p>Po [ ] Jo [ ]</p> <p>Nëse po, të listohen me të dhënat konkrete:</p> <hr/>
<p><b>Emri, Mbiemri</b> _____</p> <p><b>Firma</b> _____</p> <p><b>Vula</b> _____</p> <p><b>Data e dorëzimit të deklaratës</b> _____</p>	

III.1.4. Nga verifikimet në sistemin e prokurimeve elektronike rezulton, se BOE “GB Civil Engineering” SHPK & “Margarita Kodra” PF, në përmbushje të kriterit sa më sipër, kanë dorëzuar:

-Shtojca nr. 12 Formulari Përmbledhës i Vetëdeklarimit nga operatori ekonomik “GB Civil Engineering” SHPK.

-Shtojca nr. 12 Formulari Përmbledhës i Vetëdeklarimit nga operatori ekonomik “Margarita Kodra” PF.

-Deklaratën (shtojca 7) nga operatori ekonomik “GB Civil Engineering” SHPK për inxhinierin topograf/gjeodet Znj. D. O.

-Deklaratën (shtojca 7) nga operatori ekonomik “GB Civil Engineering” SHPK për inxhinierin mekanik Z. N. M.

-Deklaratën (shtojca 7) nga operatori ekonomik “Margarita Kodra” PF për inxhinierin ndërtimi (drejtues projekti) Znj. M. K.

-Deklaratën (shtojca 7) nga operatori ekonomik “Margarita Kodra” PF për inxhinierin mjedisit/kimist teknolog Znj. D. P.

Nga verifikimet në sistemin e prokurimeve elektronike rezulton, se bashkimi i operatorëve ekonomikë “GB Civil Engineering” SHPK & “Margarita Kodra” PF kanë nënshkruar një marrëveshje bashkëpunimi me datë 01.08.2023, për bashkimin ndërmjet këtyre shoqërive të mësipërme përmes administratorëve të tyre, për bashkëpunim të përkohshëm të shoqërive me rastin e pjesëmarrjes për tenderin me Autoritet Kontraktor “Autoriteti Rrugor Shqiptar” me objekt “*Supervizion punimesh, riveshje dhe sistemim asfaltim nyja Shkozet mbikalimi Plepa*”, ku sipas së cilës: Shoqëria “GB Civil Engineering” SHPK- Shërbimet bazë do të kryhen nga shoqëria “GB Civil Engineering” SHPK, deri në përmbushjen e plotë të shërbimit në masën 95%. Subjekti “Margarita Kodra” PF – do të mbulojë në këtë bashkëpunim me shërbimin e inxhinierit të ndërtimit dhe mobilizim të përgjithshëm në masën deri 5 %.

III.1.5. Në pikën 2, të nenit 14 të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, parashikohet shprehimisht se: “*2. Grupe operatorësh ekonomikë mund të dorëzojnë oferta ose të paraqiten si një kandidat i vetëm sipas parashikimeve në rregullat e prokurimit publik. Autoriteti ose enti kontraktor nuk duhet t’i kërkojë një formë të veçantë ligjore bashkimit të shoqërive, për qëllim të dorëzimit të ofertës ose kërkesës për pjesëmarrje. Autoritetet ose entet kontraktore mund t’u kërkojnë grupeve të operatorëve ekonomikë që të marrin një formë ligjore specifike, pasi të jenë shpallur fitues, nëse vlerësohet e nevojshme për realizimin e kontratës. Në çdo rast, ky kusht duhet t’u bëhet i ditur operatorëve ekonomikë në dokumentet e tenderit për ekzekutimin e kënaqshëm të kontratës*”.

Në nenin 77, pikën 5 të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, parashikohet shprehimisht se: “*5. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë në njoftimin e kontratës ose në ftesën për shprehje interesi kriteret e përzgjedhjes, si dhe dokumentet konkrete që duhet të paraqesin operatorët ekonomikë për përmbushjen e këtyre kritereve*”.

Në pikat 1 dhe 2 të nenit 82 “Formulari përmbledhës i vetëdeklarimit”, të LPP-së përcaktohet se: “*1. Bashkë me dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, autoritetet ose entet kontraktore pranojnë si provë paraprake në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose palë të treta, formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas parashikimeve të këtij ligji. Përmbajtja e këtij formulari përcaktohet në rregullat e prokurimit publik. Kur autoriteti ose enti kontraktor mund t’i marrë dokumentet mbështetëse duke u futur direkt në një bazë të aksesueshme të dhënash shtetërore, në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit përcaktohet edhe informacioni që kërkohet për këtë qëllim, siç është adresa në internet e bazës të të dhënave, çdo e dhënë identifikimi dhe, sipas rastit, në deklaratën e nevojshme për dhënien e pëlqimit. Operatorët ekonomikë mund të përdorin një formular vetëdeklarimi që është përdorur gjatë një procedure prokurimi të mëparshme, nëse informacioni që ajo përmban vazhdon të jetë i saktë dhe i vlefshëm.*”



2. Në çdo kohë gjatë procedurës, autoriteti ose enti kontraktor mund t'u kërkojë ofertuesve dhe kandidatëve sqarime dhe dokumente mbështetëse për këto sqarime, kur kjo është e nevojshme për të garantuar zbatimin korrekt të procedurës.

Ndërsa në nenin 92/3 të LPP-së përcaktohet se: “3. Autoriteti ose enti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një ofertë të vlefshme vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentet e tenderit, pa rënë ndesh me përcaktimet e nenit 38 të këtij ligji...”.

III.1.6. Në nenin 26 “Formulari përmbledhës i vetëdeklarimit”, pikat 1, 2, 3, 6 dhe 7 të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, parashikohet shprehimisht se: “1. Bashkë me dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, autoriteti/enti kontraktor pranon si provë paraprake, në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose palë të treta, formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas përcaktimit në nenin 82, të LPP-së, dhe në këto rregulla.

2. Formulari përmbledhës i vetëdeklarimit përmban informacion dhe deklarimin, si më poshtë vijon:

a) operatori ekonomik është i regjistruar në regjistrin tregtar sipas legjislacionit të vendit ku ushtron aktivitetin ose sipas legjislacionit të posaçëm, në rastin e një organizate jofitimprurëse, ka në fushën e veprimtarisë objektin e prokurimit, dhe ka statusin aktiv;

b) operatori ekonomik nuk është dënuar për asnjë nga veprat penale, të parashikuara në pikën 1, të nenit 76, të LPP-së;

c) personi/at në cilësinë e anëtarit të organit administrativ, drejtuesit ose mbikëqyrësit, aksionerit ose ortakut, ose që ka kompetenca përfaqësuese, vendimmarrjeje ose kontrolluese brenda operatorit ekonomik, nuk është ose ka qenë i dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë për asnjë nga veprat penale, të përcaktuara në pikën 1, të nenit 76, të LPP-së;

ç) operatori ekonomik nuk është dënuar me vendim të gjykatës së formës së prerë, për vepra që lidhen me veprimtarinë profesionale;

d) operatori ekonomik nuk është në proces falimentimi;

dh) operatori ekonomik ka paguar të gjitha detyrimet për pagimin e tatimeve e të kontributeve të sigurimeve shoqërore, sipas parashikimeve të pikës 2, të nenit 76, të LPP-së;

e) operatori ekonomik ka shlyer të gjitha detyrimet e maturuara të energjisë elektrike, dhe përmbush kërkesat që rrjedhin nga legjislacioni i fushës në fuqi. Ky informacion kërkohet për operatorët ekonomikë, të cilët ushtrojnë veprimtarinë në territorin e Republikës së Shqipërisë;

ë) operatori ekonomik nuk ndodhet në kushtet e konfliktit të interesit, sipas legjislacionit në fuqi;

f) operatori ekonomik ushtron aktivitetin në zbatim të kërkesave ligjore të legjislacionit mjedisor, social dhe të punës;

g) operatori ekonomik ka paraqitur ofertë të pavarur, sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi;

gj) operatori ekonomik përmbush specifikimet teknike, sipas kërkesave të përcaktuara nga autoriteti/enti kontraktor;

h) operatori ekonomik disponon fuqinë punëtore, të nevojshme për ekzekutimin e kontratës, sipas kërkesave të autoritetit/entit kontraktor (kur është rasti);

i) operatori ekonomik disponon mjetet dhe makineritë e nevojshme për ekzekutimin e kontratës, sipas kërkesave të autoritetit/entit kontraktor, kur është rasti;

j) informacion mbi subjektet, mbi kapacitetet e të cilave, operatori ekonomik do të mbështetet, nëse është rasti dhe nënkontraktorët e mundshëm, nëse është rasti;

k) operatori ekonomik ushtron aktivitetin konform kërkesave të legjislacionit në fuqi.

3. Informacioni i pasqyruar në formularin e vetëdeklarimit, i cili gjendet në një bazë të dhënash, ku autoriteti/enti kontraktor mund të aksesojë direkt këtë informacion dhe /ose dokumentin, duhet të shoqërohet me adresën përkatëse për këtë bazë të dhënash

6. Në çdo rast, përpara se të japë kontratën, autoriteti/enti kontraktor duhet t'i kërkojë ofertuesit fitues që të dorëzojë dokumentet provuese për vetëdeklarimet në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, si dhe dokumentet e paraqitura si pjesë e ofertës në rrugë elektronike. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njësuara me origjinalin. Autoriteti/enti kontraktor pranon një dokument të lëshuar nga i njëjti institucion ose palë e tretë dhe që ka të njëjtin informacion me atë të paraqitur në procedurën e zhvilluar në mënyrë elektronike.

7. Në çdo rast, autoriteti/enti kontraktor ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme mbi vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga operatori ekonomik si më sipër, ose t'i kërkojë operatorit sqarime dhe dokumente mbështetëse për këto sqarime.

Në nenin 54, pikat 1, 5, 9 dhe gërma "a" e pikës 11 të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", i ndryshuar, parashikohet shprehimisht se: "1. Shërbim konsulence është një procedurë prokurimi me faza, e cila përdoret në rrethanat e parashikuara në nenin 50 të LPP-së, për shërbime të një natyre intelektuale dhe/ose këshilluese.

5. Njoftimi i kontratës për shërbimin e konsulencës hartohet dhe publikohet në sistemin e prokurimeve elektronike dhe në Buletinin e Njoftimeve Publike. Ky njoftim përshkruan nevojat dhe kërkesat e autoritetit/entit kontraktor, karakteristikat e kontratës dhe kriteret minimale të përzgjedhjes së kandidatëve. Njësia e prokurimit apo edhe struktura të specializuara duhet të hartojnë projektkontratën me përkufizime të qarta të objektivave, qëllimeve dhe të synimit të detyrës në fjalë dhe dokumentet e tenderit. Çdo operator i interesuar ekonomik mund të dorëzojë një kërkesë për pjesëmarrje në fazën e parë të kualifikimit, duke dhënë informacionin që kërkohet, nga autoriteti/enti kontraktor.

9. Përcaktimet e parashikuara në këtë nen janë njësoj të zbatueshme për konsulentin, si person fizik ose juridik, për stafin e konsulentit dhe nënkonsulentët, si dhe për bashkimet e konsulentëve. Konsulentët mund të bashkohen me njëri-tjetrin, në formën e një bashkimi konsulentësh ose me një marrëveshje nënkonsulence, për plotësimin e fushave të tyre

*përkatëse të ekspertizës për fuqizimin e anës teknike të propozimeve të tyre dhe për vënien në dispozicion të një ekipi më të madh ekspertësh, për të ofruar propozime më të mira dhe, në disa raste, për të ofruar çmime më të ulëta. Një bashkim i tillë mund të krijohet për një afat të gjatë, pavarësisht nga detyra specifike ose mund të krijohet edhe për një detyrë të veçantë. Në çdo rast, ky bashkim duhet të dokumentohet me një kontratë të lidhur. Në rastin e bashkimit të konsulentëve secili prej tyre duhet të plotësojë kriteret detyruese për kualifikim sipas nenit 76, të LPP-së, ndërkohë kërkesat për kualifikim sipas përcaktimit në nenin 77, të LPP-së, dhe këto rregulla plotësohen bashkërisht nga i gjithë bashkimi.*

*11. Hapat e procedurës së shërbimit të konsulencës janë:*

*a) Në fazën e parë të kualifikimit, autoriteti/enti kontraktor përgatit preventivin e kostos dhe buxhetit, të cilat janë pjesë e njoftimit të kontratës. Preventivi i kostos bazohet në vlerësimin që autoriteti ose enti kontraktor u bën burimeve që i nevojiten për të përmbushur detyrën: kostoja për stafin, mbështetja logjistike dhe inputi fizik. Kostot duhet të ndahen në dy kategori kryesore:*

*i. tarifat (ose shpërblimi);*

*ii. rimbursimet.*

*Në nenin 88 “Bashkimi i operatorëve ekonomikë”, pikat 1, 2 dhe 3 të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, parashikohet shprehimisht se: “1. Oferta mund të paraqitet nga një bashkim operatorësh ekonomikë, sipas përcaktimit të pikave 2 dhe 3, të nenit 14, të LPP-së, ku njëri prej të cilëve i përfaqëson të tjerët gjatë procedurës dhe, në rast përzgjedhjeje, edhe gjatë zbatimit të kontratës. Në ofertë duhet të përcaktohet pjesa e shërbimit, punës ose furnizimit, që do të kryejë secili nga anëtarët e këtij bashkimi nëpërmjet një kontrate bashkëpunimi të hartuar ndërmjet palëve.*

*2. Anëtarët e bashkimit të operatorëve ekonomikë caktojnë në kontratën e bashkëpunimit ndërmjet tyre përfaqësuesin e tyre për dorëzimin e ofertës. Kjo kontratë bashkëpunimi duhet të dërgohet së bashku me kualifikimet dhe ofertën ekonomike, e cila duhet të nënshkruhet nga përfaqësuesi. Përfaqësuesi duhet të bëjë edhe sigurimin e ofertës, duke specifikuar pjesëmarrjen në bashkimin e operatorëve ekonomikë.*

*3. Secili prej anëtarëve të këtij bashkimi duhet të përmbushë kërkesat e parashikuara në nenin 76, të LPP-së, dhe ato të përcaktuara në dokumentet e tenderit. Kërkesat për kualifikim: ekonomike, financiare, profesionale dhe ato teknike, duhet të përmbushen nga i gjithë bashkimi, në përputhje me përqindjen dhe/ose natyrën e pjesëmarrjes në punë, shërbim apo furnizim, të përcaktuara në aktmarrëveshje”.*

**III.1.7. Referuar frymës së legjislacionit për prokurimin publik, vendosja e kriterëve të veçanta për kualifikim ka si synim kryesor që t’i shërbejë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet ekonomike, financiare dhe organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës. Kriteret kualifikuese të përcaktuara nga**

autoriteti kontraktor janë të detyrueshme për t'u përmbushur nga të gjithë ofertuesit ekonomikë pjesëmarrës në një procedurë prokurimi. Autoriteti kontraktor do të konsiderojë një ofertë të vlefshme, vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentet e tenderit. Për pasojë, Komisioni gjykon, se operatorët ekonomikë pjesëmarrës në një procedurë prokurimi duhet të plotësojnë vetëm kërkesat e vendosura në dokumentet e tenderit, e rrjedhimisht, vlerësimi e kualifikimi i tyre duhet të bëhet në përputhje vetëm me këto kërkesa. Në rastin e bashkimit të operatorëve ekonomikë, grupe operatorësh ekonomikë mund të dorëzojnë oferta ose të paraqiten si një kandidat i vetëm sipas parashikimeve në rregullat e prokurimit publik. Gjithashtu, në fazën e vlerësimit, autoriteti kontraktor duhet të mbajë në konsideratë parashikimin e nenit 88, pika 3 e VKM, sipas së cilit secili prej anëtarëve të këtij bashkimi duhet të përmbushë kërkesat e parashikuara në nenin 76, të LPP-së, dhe ato të përcaktuara në dokumentet e tenderit. Kërkesat për kualifikim: ekonomike, financiare, profesionale dhe ato teknike, duhet të përmbushen nga i gjithë bashkimi, në përputhje me përqindjen dhe/ose natyrën e pjesëmarrjes në punë, shërbim apo furnizim, të përcaktuara në aktmarrëveshje.

Autoriteti kontraktor në kriteret kualifikuese të përcaktuara përkatësisht në pikat 2.3.3 të Shtojcës 11 të dokumenteve të tenderit, ka kërkuar që operatori ekonomik të deklarojë se disponon stafin inxhinierik, për realizimin e shërbimeve objekt - kontrate, por Autoriteti kontraktor nuk ka kërkuar që operatori ekonomik të deklarojë se stafi inxhinierik, që disponon nuk duhet të jetë i angazhuar në kontrata të tjera apo të deklaruar në procedura të shpallura fitues, siç ka cituar në arsyet e skualifikimit. Pra, referuar kriterëve të veçanta të kualifikimit, konkretisht pika 2.3.3, në fund të saj, autoriteti është shprehur, se kriteri konsiderohet i përmbushur me paraqitjen e formularit të vetëdeklarimit sipas shtojcës 12 të dokumenteve standarde të tenderit. Nga shqyrtimi i dokumentacionit të administruar, Komisioni i Prokurimit Publik, konstaton, se për përmbushjen e këtij kriteri çdo anëtar i bashkimit të operatorëve ekonomikë ankimes ka dorëzuar në sistemin e prokurimit elektronik (SPE), Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit (shtojca 12). Gjithashtu, secili prej bashkimit të operatorëve ekonomikë, ka dorëzuar edhe deklaratën “Mbi disponueshmërinë e anëtarit të stafit të konsulentit”, duke cituar pikën 2 të saj: “*Jam i disponueshëm në realizimin e objektit të prokurimit, sipas kushteve dhe afateve të përcaktuara nga autoriteti/enti kontraktor*”. KPP gjykon, se bashkimi i operatorëve ekonomikë e ka plotësuar kriterin kualifikues të sipërpërmendur, duke dëshmuar se disponon stafin e kërkuar nëpërmjet plotësimit të shtojcës 12, Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit si dhe shtojcën nr. 7.

Nga shqyrtimi në tërësi i dokumentacionit dhe informacionit të dorëzuar nga autoriteti kontraktor nuk rezulton që autoriteti kontraktor të ketë kërkuar dokumentacionin e stafit, nga ana e bashkimit të operatorëve ekonomikë ankimes, por meqenëse njëri nga bashkimi i operatorëve ekonomikë konkretisht “GB Civil Engineering” SHPK, i cili është përfitues në një kontrate tjetër po me këtë autoritet kontraktor, Autoriteti Rrugor Shqiptar, konkretisht kontratën me objekt “Supervizion punimesh përfundimi i punimeve në segmentin rrugor Ura e Kranesë –Qafë Botë, Ura e Kranesë-Ura Gajdarit dhe përmirësimi i segmentit rrugor Shijan-Ura e Gajdarit, Komisioni i Vlerësimit të Ofertave ka verifikuar deklaratimet e mëparshme të bëra nga ofertuesi në fjalë, në fazën e ofertimit dhe për të cilën është shpallur

fituese, ku sipas informacionit të entit kontraktor është në fazën e zbatimit të shërbimit dhe nga ku rezulton, se disa nga pjesëtarët e stafit janë të angazhuar në këtë kontratë të sipërcituar, fakt të cilin autoriteti kontraktor e ka dhënë si argument në arsyen e skualifikimit të datës 07.08.2023. Lidhur me këtë arsye skualifikimi, ndonëse në kriteret kualifikuese të përcaktuara në pikën 2.3.3, të Shtojcës 11 të dokumenteve të tenderit, nga ana e autoritetit kontraktor nuk është përcaktuar që punonjësit, nuk duhet të jenë të angazhuar në kontrata të tjera apo të deklaruar në procedura të shpallura fitues, por është përcaktuar vetëm fakti se këto kriteret konsiderohen të plotësuara me plotësimin dhe dorëzimin e Shtojcës 12 “*FORMULARI PËRMBLEDHËS I VETËDEKLARIMIT*”. Komisioni i Prokurimit Publik nga shqyrtimi i Shtojcës 12 konstaton, se në pikën B “*Për disponimin e punonjësve dhe makinerive të nevojshme (nëse kërkohen)*” për stafin teknik që disponon dhe që kërkohen për të realizuar objektin e kontratës për të cilën oferton duhet të deklarojnë se: “*Në cilësinë e operatorit ekonomik, deklaroj nën përgjegjësinë time të plotë se: Unë kam punonjësit e nevojshëm si dhe mjetet dhe makineritë për ekzekutimin e kontratës, siç përcaktohet në dokumentet e tenderit, dhe e vërtetoj këtë me dokumentacionin përkatës, të cilin do ta paraqes në kopje origjinale ose të noterizuar nëse fitoj, ose nëse më kërkohen sqarime nga autoriteti/enti kontraktor*”. Nga shqyrtimi i Shtojcës 12 “*FORMULARI PËRMBLEDHËS I VETËDEKLARIMIT*” të datës 01.08.2023, të dorëzuar nga operatori ekonomik ankimues “GB Civil Engineering” SHPK, Komisioni konstaton, se pika B e kësaj shtojce është plotësuar duke bërë deklaratimet e kërkuara, ndërsa lidhur me arsyen e skualifikimit të datës 07.08.2023, Komisioni gjykon, se arsyeja e skualifikimit të dhënë nga ana e Komisionit të Vlerësimit të Ofertave me argumentin se një nga inxhinierët e stafit inxhinierik i deklaruar në Shtojcën 12 “*FORMULARI PËRMBLEDHËS I VETËDEKLARIMIT*” të datës 01.08.2023 është i angazhuar në kontratë tjetër, për të cilën është shpallur fitues operatori ekonomik “GB Civil Engineering” SHPK, e cila është në fazë implementimi të shërbimit, nuk qëndron, pasi në pikën B të Shtojcës 12 nuk është parashikuar që të deklarohej, që ky staf të mos jetë i angazhuar në kontrata të tjera apo të deklaruar në procedura të shpallura fituese, por është parashikuar që të deklarohej se ky ofertues ka stafin e nevojshëm për ekzekutimin e kontratës siç përcaktohet në dokumentet e tenderit, duke e plotësuar kriterin kualifikues të përcaktuar në pikën 2.3.3, të Shtojcës 11 të dokumenteve të tenderit.

Për më tepër, referuar Ligjit 120/2020 “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 8402, datë 10.9.1998, “*Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit*”, të ndryshuar dhe në Udhëzim nr.3, datë 15.2.2001 “*Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit*” i ndryshuar, parashikohet se “*Mbikëqyrës i punimeve*” është personi fizik ose juridik, vendas apo i huaj, i licencuar për ushtrimin e mbikëqyrjes së punimeve, i cili ka përgjegjësi kontrollin e mbarëvajtjes së të gjithë procesit të zbatimit të punimeve në përputhje me projektin, kushtet teknike të projektimit, të zbatimit, grafikun e punimeve, si dhe destinacionin e objektit, duke pasur parasysh edhe anën ekonomike të tij. Sipas dispozitave ligjore të sipërcituara nuk kemi të pasqyruar apo cituar në asnjë prej tyre mbi disponueshmërinë e stafit mbikëqyrës apo anëtarit të stafit të konsulentit.

Në përfundim të analizës së fakteve përkatëse, Komisioni arrin në konkluzionin, se dokumentacioni i paraqitur nga operatori ekonomik ankimues në procedurën e prokurimit, plotëson kërkesat e autoritetit kontraktor dhe konsiderohet i vlefshëm. KPP gjykon, se arsyeja e skualifikimit për operatorin ekonomik në rastin konkret, nuk është në përputhje me kriteret e kualifikimit të vendosur nga autoriteti kontraktor për plotësimin e kapacitetit teknik, por një kriter i pakërkuar. Në këto kushte, Komisioni gjykon, se skualifikimi i operatorit ekonomik ankimues nga ana e autoritetit kontraktor nuk është i drejtë. Në mënyrë eksplicite ligji për prokurimin publik parashikon, se vlerësimi i ofertave duhet bërë vetëm në përputhje me kriteret e kualifikimit të parashikuara në dokumentet e procedurës përkatëse. Vlerësimi i ofertave referuar kritereve të tjera të kualifikimit të cilat në asnjë rast nuk janë parashikuar në dokumentet e procedurës së prokurimit, cenon parimet kryesore të zhvillimit të procedurës së prokurimit, parashikuar nga neni 3 i lex specialis, atë të barazisë në trajtimin e kërkesave dhe detyrimeve që i ngarkohen ofertuesve. Komisioni i Prokurimit Publik, gjykon, se është me vend të theksojë rolin e posaçëm që ka autoriteti kontraktor, për vetëcilësimin e tij ligjor, si autoriteti me interes dhe përgjegjësi thelbësore për realizimin e suksesshëm të kontratës. KPP sjell në vëmendje, se referuar rregullave të prokurimit publik, është pikërisht autoriteti kontraktor ai që duhet të monitorojë zbatimin e kontratës, për t'u siguruar nëse cilësia e shërbimeve është e njëjtë me cilësinë e premtuar në ofertë dhe të përcaktuar në kontratë. Në përfundim të analizës së fakteve përkatëse, Komisioni arrin në konkluzionin, se dokumentacioni i paraqitur nga operatori ekonomik ankimues në procedurën e prokurimit, plotëson kërkesat e autoritetit kontraktor dhe konsiderohet i vlefshëm.

Për sa më lart, pretendimi i bashkimit të operatorëve ekonomikë ankimues “GB Civil Engineering” SHPK & “Margarita Kodra” PF qëndron.

Për sa më sipër, në mbështetje të neneve 30, dhe 118 të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 236, datë 20.04.2023, “Për përcaktimin e rregullave dhe tarifës së pagesës për ankimin në një procedurë prokurimi pranë Komisionit të Prokurimit Publik”, Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, nenit 4, të Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19”, Komisioni i Prokurimit Publik, Komisioni i Prokurimit Publik, njëzëri,

### **Vendosi**

1. Të pranojë ankesën e paraqitur nga bashkimi i operatorëve ekonomikë “GB Civil Engineering” SHPK & “Margarita Kodra” PF në procedurën e prokurimit “Shërbim Konsulencë”, me Nr. REF-75634-07-20-2023, me objekt: “Supervizion punimesh, riveshje dhe sistemim asfaltim nyja Shkozë mbikalimi Plepa”, me fond limit

1,346,516.84 lekë (pa TVSh), zhvilluar me datë 01.08.2023 nga autoriteti kontraktor, Autoriteti Rrugor Shqiptar.

2. Autoriteti kontraktor të anulojë vendimin e KVO-së mbi skualifikimin e bashkimit të operatorëve ekonomikë “GB Civil Engineering” SHPK & “Margarita Kodra” PF, duke e kualifikuar këtë bashkim operatorësh.
3. Autoriteti kontraktor, brenda 5 ditëve, të vërë në dijeni Komisionin e Prokurimit Publik për zbatimin e vendimit, duke dokumentuar veprimet e kryera.
4. Ngarkohet zyra e financës të bëjë kthimin e tarifës financiare të paguar nga bashkimi i operatorëve ekonomikë “GB Civil Engineering” SHPK & “Margarita Kodra” PF.
5. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Apelit.
6. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.  
Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

### **KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK**

**Anëtar**

**Anëtar**

**Kreshnik Ternova**

**Anila Malaj**

**Kryetar**

**Jonaid Myzyri**